

OPINION ZYRTAR I LËVIZJES SOCIALISTE PËR INTEGRIM LIDHUR ME AMENDAMENTET KUSHTETUESE

Lëvizja Socialiste për Integrim, pasi shqyrtoi projektin e dorëzuar nga grupi i ekspertëve të caktuar për hartimin e draftit për ndryshime kushtetuese, pasi u njoh edhe me procesin e ndjekur për hartimin e këtij drafti, shpreh këtë qëndrim zyrtar:

I. SI E LEXUAM DRAFT OPINIONIN E KOMISIONIT TË VENECIAS MBI DRAFT AMENDAMENTET KUSHTETUESE PËR GJYQËSORIN

1. Përpos sugjerimeve të karakterit të thjeshtë teknik, opinioni i Komisionit të Venecias ndalet në disa çështje parimore dhe thelbësore, që duhet të karakterizojnë reformën në sistemin e drejtësisë në Republikën e Shqipërisë. Komisioni i Venecias vë theksin në 3 çështje kryesore që duhet të udhëheqin hartimin e amendamenteve Kushtetuese:

- a. Konsensusi;
- b. Ndërhyrje minimaliste në tekstin e Kushtetutës;
- c. Thjeshtimi (reduktim) i institucioneve të reja të propozuara paraprakisht.

2. Garancitë që lidhen me procesin (duke patur në konsideratë pjesën e mbetur të tij), nënkuptojnë kryesisht dhe para së gjithash vendimmarrje të një natyre politike nga ana e Kuvendit, duke kuptuar dhe nënkuptuar si themel të domosdoshëm konsensusin politik, që do të thotë pjesëmarrjen aktive të opozitës në miratimin e ndryshimeve kushtetuese.

2.1. Kushtetuta është origjina e ligjshmërisë së një vendi. Ajo konsiderohet si një pakt qytetar, është baza e ligjshmërisë së shtetit, ku mishërohen në mënyrë të imunizuar të drejtat dhe detyrat e qytetarëve. Kushtetuta ka rëndësi jetike, pasi përbën kornizën ligjore që normon veprimtarinë e shtetit. Për këtë arsye lind domosdoshmëria që jo vetëm përmbajtja, por dhe forma e saj të jenë ideale. **Si forma, si përmbajtja e amendamenteve të paraqitura duhet të gjejnë konsensusin e të gjithë aktorëve politikë, duke ndikuar kështu dhe në besimin publik për ndërhyrjet në Kushtetutë.** Pjesëmarrja e të gjitha forcave është e domosdoshme për të garantuar jetëgjatësinë e procesit.

3. Ndërhyrje minimaliste në tekstin e Kushtetutës.

3.1. Modeli i propozuar i ndryshimeve Kushtetuese është ende larg qasjes së propozuar dhe nga Komisioni i Venecias për ndërhyrje dhe ndryshime minimaliste në tekstin e Kushtetutës. Sigurisht që opinioni i Komisionit të Venecias, nuk duhet të saktësojë nga pikëpamja sasiore se sa duhet të jenë këto ndryshime, por drafti i propozuar prej 57 nenes, qartësisht është larg kësaj qasjeje. Rëndësia dhe impakti i procesit/kësaj reforme, natyrisht që kërkojnë ndryshime kushtetuese të karkaterit thelbësor, por jo sasior. Ndërhyrja me 57 nene në një tekst kushtetues me 183 nene, praktikisht e sjell frymën më shumë drejt një kushtetute të re, sesa drejt ndryshimeve kushtetuese. Edhe nga pikëpamja e teknikës legjislative, një hap i tillë nuk është i rekomandueshëm;

3.2. Sugjerimi ynë është të hartojme një projekt amendamentesh të shkurtuara dhe të natyrës parimore.

4. Thjeshtimi (reduktimi) i numrit të institucioneve.

4.1. Procesi konsensual, ndërhyrjet minimaliste, që lidhen më shumë me formën e paraqitjes së amendimeve dhe procesin, ka dhe një anë tjetër që do duhet konsideruar edhe sipas opinionit të Komisionit të Venecias, ai i thjeshtimit të skemës institucionale. Para krijimit të një skeme të re organizimi të sistemit të drejtësisë, **vlerësojmë se më parë duhet të kishte një lidhje logjike mes zgjidhjeve të propozuara lidhur me modelimin e institucioneve të sistemit të drejtësisë dhe përfundimeve të arritura nga Analiza e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri.** Një zgjidhje mund të ishte që bazuar mbi këtë analizë, të propozoheshin ndryshime që garantojnë funksionimin e institucioneve ekzistuese, duke ndryshuar rregullat e funksionimit të tyre, bazuar në analizën funksionale të këtyre institucioneve;

4.2. Në këtë kuptim, mund të ishte mjaftueshëm ndryshimi në përbërjen e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, duke përfshirë dhe sistemin e prokurorisë brenda KLD-së dhe duke ndryshuar raportin *gjyqtar me jo gjyqtarë* si anëtarë të KLD-së, për të shmangur korporatizmin evident të deritanishëm;

4.3. Një qasje e tillë shkon kah thjeshtimit të skemës së institucioneve, siç propozon Komisioni i Venecias, pasi edhe nga pikpamja e parimit të unitarizmit, do ishte më e pranueshme që në vend të dy këshillave apo dy trupave (gjyqësor dhe prokurori) të kishim një të vetëm;

4.4. Në këtë skemë të re të ideuar, Tribunali i Drejtësisë është një zgjidhje e pranueshme dhe që nuk e ngarkon skemën ekzistuese të institucioneve, qoftë dhe për faktin se do të jetë një organizëm *ad hoc*, që zgjidh disa prej ngërçeve të krijuara nga skema aktuale e institucioneve të drejtësisë;

4.5. Ndërkohë që inspektimi shkon kah unitetit, emërimi dhe disiplinimi ndahet. Ky lloj dyzimi në konceptim të institucioneve shkon në drejtime të kundërta.

II. GJYKATA KUSHTETUESE

5. Në debatin publik të zhvilluar lidhur me Gjykatën Kushtetuese, diskutimet mbi përbërjen ndahen në dy drejtime: atë të emërimit të anëtarëve të saj me shumicë të cilësuar prej 3/5, apo me shumicë të cilësuar prej 2/3.

6. Në kuptimin tonë, mendojmë se sugjerimi i Komisionit të Venecias, referuar rastit të Hungarisë, nuk lidhet detyrimisht me shumicën e cilësuar, por me përfshirjen e opozitës në procesin e emërimit dhe në një vendimmarrje konsensuale.

7. Një shembull i mirë që ka funksionuar sa i përket vendimmarrjes konsensuale dhe që nuk lidhet me vendimmarrjen me shumicë të cilësuar, duke ruajtur balancën, është zgjedhja e anëtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Gjithashtu praktika e derisotme në emërimin e gjyqtarëve të gjykatës Kushtetuese sipas një marrëveshje politike për paritet ndërmjet pozitës dhe opozitës, ka dhënë rezultat. Gjykata Kushtetuese në sjelljen e saj nuk ka krijuar shumë hapësira për kontestim publik. Ajo ka qenë dhe mbetet një gjykatë jo e kontestuar.

8. Lëvizja Socialiste për Integrim ka një propozim që e zgjidh këtë ngërç, propozim i cili gjendet në analizën teknike të draft amendamenteve. Ky propozim thjeshton jo vetëm procedurën, por shmang dhe ngërçet e mundshme në Kuvend gjatë zgjedhjes së

anëtarëve, siç po ndodh rëndom prej dy vitesh për zgjedhjen e anëtarëve të Gjykatës së Lartë.

III. ROLI I MINISTRIT TË DREJTËSISË

9. Nuk ka asnjë dyshim se sugjerimi i Komisionit të Venecias lidhur me prezencën e Ministrisë të Drejtësisë në Tribunalin Gjyqësor është logjik. Është gjithashtu logjike që, prania e Ministrisë të Drejtësisë si anëtar i trupës që emëron/shkarkon gjyqtarët dhe prokurorët, është e tepërt.

10. Por nga ana tjetër, prania e Ministrisë të Drejtësisë nuk duhet të vërë në dyshim parimin e kontrollit dhe balancës. Ministri duhet të jetë ura lidhëse mes gjyqësorit dhe ekzekutivit.

11. Projekti i propozuar, sugjeron me të drejtë që funksioni i inspektimit dhe procedimit disiplinor të gjyqtarëve dhe prokurorëve t'i hiqet Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe t'i kalojë një institucioni të ri Kushtetutes, që është Inspektorati i Lartë i Drejtësisë. Nëse kjo pranohet, së pari do krijohet një Ministër Drejtësie paralel. Ne mendojmë dhe sugjerojmë që funksioni i inspektimit në mënyrë të natyrshme, siç ndodh në shumicën e vendeve dhe praktikave Europiane dhe në kushtet kur i hiqet Këshillit të Lartë të Drejtësisë, t'i mbetet Ministrisë të Drejtësisë, ndryshe, rreziku është i lartë për krijimin e një korporatizmi me cikël të mbyllur.

12. Krijimi i një inspektorati të pavarur të shkëputur nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë apo Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, në dukje krijon përshtypjen e një zgjidhjeje optimale, por rrit rrezikun e deritanishëm prezent lidhur me llogaridhënien dhe përgjegjshmërinë. Prandaj, për të vendosur balancën ndërmjet pushteteve, sugjerojmë vendosjen e Ministrisë të Drejtësisë në detyrën publike të iniciimit të procedimit disiplinor dhe të përfaqësimit të kësaj procedurë para organit vendimmarrës, ku tashmë nuk është anëtar. Pra Ministri është palë në proces dhe jo vendimmarrës. Natyrisht ligji duhet të vendosë garanci të plotë që, kur kjo detyrë nuk ushtrohet nga Ministri, të ketë mundësi t'a ushtrojë atë Kryetari i Gjykatës së Lartë ose vetë Prokurori i Përgjithshëm.

13. Edhe në kushtet kur si opion i pranueshëm do të jetë Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si dy institucione të ndryshme, për përbërjen e tyre mund të ndiqet shembulli Kroat, që garanton pluralitet të zgjedhjes dhe përfaqësimit, sikurse rekomandon opinionin e Komisionit të Venecias (një shembull i mirë zgjedhjeje mund të ishte modeli kroat, sipas të cilit një vend nga anëtarët që zgjedh Kuvendi, i garantohet opozitës parlamentare). Kjo shmang dhe debatin bllokues të momentit, 3/5, apo 2/3, si dhe garanton mosbllokimin e procesit në të ardhmen, si dhe çdo opozitë e rradhës do të ndihet e përfaqësuar nga këto institucione.

IV- GJYKATA E LARTË

14. Siç ka evidentuar edhe analiza e bërë, por edhe përvoja e viteve të fundit, konfirmon që Gjykata e Lartë vetëm **de jure** është e tillë. **De facto**, vepron si një Gjykatë Kasacioni, për të mos thënë që rëndom kthehet dhe në një gjykatë të shkallës së tretë. Përpos të qënurit larg një gjykatë eficiente, Gjykata e Lartë për më tepër, nuk mund të realizojë funksionin që kushtetuta aktuale i atribuon, atë të unifikimit të praktikës gjyqësore. Në këtë kuptim, konfirmimi tashmë *de jure* dhe *de facto* i një gjykate që garanton unifikimin e praktikës gjyqësore dhe shmangien nga modeli *de facto* i një gjykate kasacioni, do të ndikonte pozitivisht si në terma të efektshmërisë apo eficiencës, ashtu edhe në terma të përmirësimit të cilësisë së dhënies së drejtësisë. Kjo lloj mënyre e të kuptuarit, nënkupton pasjen e një gjykate të vetme të lartë, me kolegje sipas juridiksioneve përkatëse dhe jo krijimin e një sistemi paralel në hierarkinë e gjykatave. Nëse do të shkonim drejt kësaj të fundit, sistemi vetëm sa do të komplikohet dhe do të ishim larg skemës së thjeshtuar që kërkon Komisionin e Venecias. Sipas logjikës së propozuar në draft amendament, do të duhej të krijoheshin sisteme paralele dhe për drejtësinë penale apo civile, përpos asaj administrative. Praktikisht do të duhej të kishim tre ose më shumë gjykata të larta.

V-PROKURORIA

15. Formulimi aktual i tekstit të Kushtetutës është mëse i mjaftueshëm dhe garanton sanksionimin e parimit se organi i vetëm që ka ekskluzivitetin e hetimit penal, është prokuroria. Nga ana tjetër, për sa kohë që Kushtetuta e lidh organizimin e prokurorisë

me atë të sistemit gjyqësor, çdo detajim i mëtejshëm do të ishte i tepërt. Sa më sipër, në tekstin e Kushtetutës duhen vetëm saktësime minimale, për t'i dhënë rolin aktiv prokurorisë.

VI- PARIMI I KARRIERËS

16. Përvoja që ka patur Shqipëria deri më tani, tregon më së miri se ka ardhur koha e zbatimit në masën 100% të parimit të karrierës brenda sistemit gjyqësor. Ky sugjerim është evidentuar edhe në Progres Raportet e Komisionit Evropian për Shqipërinë. Ka ardhur momenti të mbyllet mundësia e futjes së juristëve nga jashtë sistemit dhe rritja në karrierë brenda sistemit gjyqësor të jetë zgjidhja dhe mundësia e vetme.

VII- MANDATET E INSTITUCIONEVE AKTUALE KUSHTETUESE

17. Mbështesim mendimin e Komisionit të Venecias se mandati i institucioneve duhet të ndërpritet vetëm në ato raste kur institucioni, pas amendamenteve kushtetuese, nuk ekziston më.

VIII- MBI VLERËSIMIN KALIMTAR TË KUALIFIKIMIT TË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE (VETTING PROÇESS)

18. Në tekstin e një Kushtetute, parashikimet e detajuara janë të tepërta dhe nuk përshtaten me natyrën që duhet të ketë ligji themeltar i një vendi. Propozimi ynë është të hartohet një dispozitë e vetme tranzitore, ku të saktësohet në mënyrë parimore procesi i Vetting. Për të kryer procesin e vlerësimit, ne propozojme që Kushtetuta të sanksionojë krijimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe çështjet për të cilat do të vendosë ky komision, e konkretisht:

- a. Integritetin moral dhe profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve;
- b. Pasurinë e tyre, në raport me deklaratimet e bëra.

19. Po kështu, për të garantuar se procesi nuk do të bllokohet gjatë fazës së implementimit, duke u ankimuar në Gjykatën Kushtetuese, është përfshirë parashikimi se: *“Ligji për Organizimin dhe Funksionimin e Procesit të Rivlerësimit, miratohet me jo më pak se 3/5 e anëtarëve të Kuvendit dhe është i paankimueshëm në Gjykatën Kushtetuese”*.

20. Drafti, në reflektim të Opinionit të Komisionit të Venecias, parashikon se kundër vendimit të Komisionit të Rivlerësimit, mund të bëhet ankim në Tribunalin Disiplinor të Drejtësisë. Ndërkohë që, përbërja, organizimi dhe funksionimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit duhet dhe do të rregullohet me ligj, jo në tekstin e Kushtetutës.

IX- ANALIZË TEKNIKE MBI DRAFTIN E PARAQITUR

21. Në vijim do të trajtojmë vetëm ato nene ku Lëvizja Socialiste për Integrim ka *sugjerime dhe propozime*.

21.1. Në lidhje me nenet që i paraprijnë anëtarësimit të Shqipërisë në BE, sugjerojmë të riformulohen sipas sugjerimeve që parashtron Komisioni i Venecias.

21.2. Neni 3 i projektit, duhet të hiqet sepse formulimi aktual në Kushtetutë është me garantues.

21.3. Neni 13 i projektit propozojmë të riformulohet si vijon:

“Në nenin 125, paragrafët 1 dhe 2 riformulohen me këtë përmbajtje:

“1. Gjykata Kushtetuese përbëhet nga 9 anëtarë.

2. Emërimi i anëtarëve për vendet vakante kryhet nga Presidenti i Republikës, i cili mbledh kandidaturat, sipas propozimit konsensual të grupeve parlamentare. Kandidaturat konsensuale votohen nga Kuvendi.

3. Në rast se grupet parlamentare nuk arrijnë të sigurojnë konsensus për propozimet, atëherë Presidenti i Republikës përcjell për votim, për çdo vend vakant, kandidatura alternative, me propozime të përbashkëta ose të veçanta të grupeve parlamentare. Në këtë rast, kandidaturat votohen me votim të

përbashkët, të fshehtë dhe të drejtpërdrejtë nga deputët e Kuvendit dhe gjyqtarët e të gjitha niveleve të pushtetit gjyqësor.

4. Deputetët dhe gjyqtarët gëzojnë të drejtën e një vote për çdo vend vakant.

5. Rregullat për procedurën e votimit përcaktohen në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të Kuvendit.

6. Gjyqtarët zgjidhen për 9 vjet, pa të drejtë riemërimi.

7. Kandidaturat për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese duhen të plotësojnë sidomos këto kritere: kandidatët duhet të kenë përvojë pune si gjyqtar jo më pak se 15 vjet, ose përvojë si jurist jo më pak se 20 vjet si prokurorë, avokatë, pedagogë të së drejtës, punonjës në administratën publike, të mos jenë dënuar më parë, të mos kenë marrë pjesë në aktivitete politike të partive politike, si dhe të mos kenë marrë pjesë në organet drejtuese të partive politike.”

21.4. Neni 16 i projektit propozojmë të riformulohet si vijon:

Neni 128 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Anëtari i Gjykatës Kushtetuese mban përgjegjësi disiplinore sipas procedurës që rregullohet me ligj. Kuvendi me tre të pestat e gjithë anëtarëve të tij, vendos për shkarkimin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese kur:

a) konstaton shkelje të rënda profesionale dhe etike gjatë ushtrimit të detyrës;

b) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;

c) vërteton faktin e pamundësisë fizike ose mendore për të ushtruar detyrën.

2. Verifikimi i shkaqeve për shkarkim, bëhet pas hetimit të tyre nga një komision i posaçëm hetimor të krijuar sipas nenit 77.”

21.5. Neni 18 propozohet të hiqet. **“Pushteti publik”** është një term i ri dhe që krijon konfuzion. Rregullimi aktual në Kushtetutë është i plotë.

21.6. Neni 19 duhet hequr dhe propozojmë të shtohet si riformulim në dispozitën trazitore, si garaci për mbrojtjen e ligjit për Vetting.

21.7. Neni 21 I projektit nuk sjell asgjë të re, prandaj duhet hequr.

21.8. Neni 23, propozojmë të hiqet sepse së pari Gjykata e Lartë Administrative nuk duhet të ekzistojë dhe së dyti, gjykatat e posaçme krijohen me ligj, sipas parashikimit të sotëm në nenin 135 të Kushtetutës.

21.9. Për nenin 24, referuar arsyetimit të mësipërm, propozojmë këtë riformulim:

Neni 136, paragrafi 1, riformulohet me këtë përmbajtje:

“1. Gjykata e Lartë përbëhet nga 17 anëtarë, të cilët emërohen nga Presidenti i Republikës, me propozim të Këshillit të Lartë Gjyqsor.

2. Brenda Gjykatës së Lartë krijohen tre kolegje që janë, kolegji civil, kolegji penal dhe kolegji administrativ.

3. Veç kriterëve dhe procedurave të përcaktuara me ligj, kandidaturat për anëtarë të Gjykatës së Lartë duhen të plotësojnë sidomos këto kritere: kandidatët duhet të kenë një përvojë pune si gjyqtar jo më pak se 15 vjet, të mos jenë dënuar më parë, të mos kenë marrë pjesë në aktivitete politike të partive politike, si dhe të mos kenë marrë pjesë në organet drejtuese të partive politike.

4. Procedura dhe kriteret e përzgjedhjes, propozimit dhe shkarkimit të anëtarëve të Gjykatës së Lartë, rregullohen me ligj.”

21.10 Neni 28 duhet të hiqet, sepse mos ulja e pagës së gjyqtarit është garanci e arritur tashmë në kushtetutën aktuale.

21.11. Në nenin 29 duhen hequr fjalët “Gjykata e Lartë Administrative”.

21.12. Në nenin 30 të hiqen fjalët “Gjykata e Lartë Administrative”.

21.13. Për nenin 31 propozojmë këtë riformulim:

Neni 141 riformulohet si vijon:

“1. Gjykata e Lartë ka si funksion njësimin e praktikës gjyqësore, duke tërhequr për shqyrtim në kolegjet e bashkuara çështje të caktuara gjyqësore.

2. Në juridiksionin e Gjykatës së Lartë mund të hyjnë edhe çështje të gjykatave më të ulta, por në çdo rast vetëm kur duhet të bëhet njësimi dhe unifikimi i praktikës gjyqësore.
3. Gjykata e Lartë ka juridiksion rishikues, vetëm si mjet i jashtëzakonshëm i ankimit gjyqësor, sipas procedurës së përcaktuar me ligj.”

21.14. Ne nenin 32 të hiqen fjalët “Gjykata e Lartë Administrative”.

21.15. Për nenin 33 propozojmë këtë riformulim:

Neni 147 riformulohet si vijon:

- “1. Këshilli i Drejtësisë funksionon pranë dhe nën kujdesin e Presidentit të Republikës. Në të marrin pjesë Ministri i Drejtësisë, Kryetari i Gjykatës së Lartë, Prokurori i Përgjithshëm, Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
2. Këshilli i Drejtësisë bën planifikimin strategjik të sistemit gjyqësor dhe atë të prokurorisë, shqyrton dhe koordinon politikat shtetërore në fushën e drejtësisë dhe është përgjegjës për garantimin e pavarësisë, përgjegjshmërisë dhe mbarëvajtjes së pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.
3. Ministri i Drejtësisë është përgjegjës për hartimin e politikave shtetërore në fushën e drejtësisë, si dhe për inspektimin dhe procedimin disiplinor të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Inspektimi dhe procedimi disiplinor kryhet brenda kufizimeve e parashikimeve të vendosura në Kushtetutë dhe në ligj. Organizimi i strukturave të inspektimit, tagrat dhe kufizimet, rregullat për shqyrtimin e procedimit, si dhe garancitë proceduriale për subjektet e procedimit, përcaktohen me ligj të veçantë.
4. Shqyrtimi i procedimit disiplinor bëhet nga organi që e ka emëruar. Ankimi kundër vendimit bëhet në Tribunalin e Drejtësisë.
5. Tribunali i Drejtësisë përbëhet nga 9 anëtarë, nga të cilët gjashtë anëtarë nga Gjykata e Lartë dhe tre anëtarë nga Gjykata Kushtetuese; të nëntë anëtarët caktohen me short. Pesë anëtarët që marrin pjesë në trupën gjyqësore, nuk marrin pjesë në Tribunalin e Drejtësisë. Rregulla më të hollësishme për shqyrtimin e procedimeve, procedurën dhe

vendimmarrjen e trupës gjyqësore dhe të Tribunalit të Drejtësië, caktohen me ligj.”

21.16. Në vijim të shtohet nen i ri me këtë përmbajtje:

Pas nenit 147, shtohet neni 147/1 me këtë përmbajtje:

“1. Këshilli i Lartë Gjyqësor përbëhet nga 9 anëtarë, 5 prej të cilëve të zgjedhur nga radhët e gjyqtarëve të të gjitha niveleve të pushtetit gjyqësor, me votim të drejtpërdrejtë, ndërsa 4 të zgjedhur nga Kuvendi, sipas parimit të paritetit të përfaqësimit të grupeve parlamentare të shumicës dhe pakicës. Kriteret dhe procedura e zgjedhjes së anëtarëve rregullohen me ligj.

2. Anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor e ushtrojnë detyrën për një periudhë prej pesë vjetësh, pa të drejtë rizgjedhjeje të njëpasnjëshme. Mandati i anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor është i lidhur me qenien gjyqtar të tij.

3. Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor zgjidhet në mbledhjen e parë të Këshillit, me 3/5 e votave të të gjithë anëtarëve. Kur në votimin e parë, Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk e arrin shumicën e kërkuar, brenda 7 ditëve nga votimi i parë bëhet një votim i dytë, në të cilin Kryetari zgjidhet me shumicë të të gjithë anëtarëve. Mandati i Kryetarit përkon me atë të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

4. Ministri i Drejtësisë merr pjesë në mbledhjet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, për të komunikuar qëndrimet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë për çështje të kompetencës së Këshillit të Lartë Gjyqësor.”

21.17. Në nenin 34 të hiqen fjalët “Gjykata e Lartë Administrative”, të hiqen pikat “c” dhe “d” e paragrafit 1, si dhe paragrafi 2.

21.18. Neni 35, 36 dhe 37 i takojnë rregullimeve ligjore dhe duhen hequr nga teksti i Kushtetutës.

21.19. Nenet 38, 39, 40 dhe 41 bien, sepse kjo propozojme të jetë funksion i Ministrisë të Drejtësisë. Pra ky institucion nuk mund të krijohet kështu siç është propozuar.

21.20. Për nenin 42 të projektit, propozojmë këtë formulim:

Pas nenit 147/ë shtohet neni 147/f, me këtë përmbajtje:

“Tribunali i Drejtësisë përbëhet nga 9 anëtarë, nga të cilët gjashtë anëtarë nga Gjykata e Lartë dhe tre anëtarë nga Gjykata Kushtetuese; të nëntë anëtarët caktohen me short. Pesë anëtarët që morën pjesë në trupën gjyqësore, nuk marrin pjesë në Tribunalin e Drejtësisë. Rregulla më të hollësishme për shqyrtimin e procedimeve, procedurën dhe vendimmarrjen e trupës gjyqësore dhe të Tribunalit të Drejtësisë, caktohen me ligj.”

21.21. Për nenin 43 propozojmë këtë riformulim:

Pikat 1 dhe 2 të nenit 148 riformulohen si vijon:

“1. Prokuroria ushtron ndjekjen penale, përfshirë hetimin penal si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj.

2. Prokurorët janë organizuar dhe funksionojnë pranë sistemit gjyqësor.

3. Kuvendi mund krijojë me ligj një njësi të specializuar hetimi që operon brenda Prokurorisë.”

21.22. Për nenin 44 propozojmë këtë riformulim:

Pas nenit 147/2, shtohet neni 147/3 me këtë përmbajtje:

“1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë përbëhet nga 9 anëtarë, 5 prej të cilëve të zgjedhur nga radhët e prokurorëve të të gjitha niveleve të pushtetit gjyqësor, me votim të drejtpërdrejtë, ndërsa 4 të zgjedhur nga Kuvendi sipas parimit të paritetit të përfaqësimit të grupeve parlamentare. Kriteret dhe procedura e zgjedhjes së anëtarëve rregullohen me ligj.

2. Anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë e ushtrojnë detyrën për një periudhë prej pesë vjetësh, pa të drejtë rizgjedhjeje të njëpasnjëshme. Mandati i anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë është i lidhur me qenien e tij prokuror.

3. Kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë zgjidhet në mbledhjen e parë të Këshillit, me 3/5 e votave të të gjithë anëtarëve. Kur në votimin e parë, Këshilli i Lartë i Prokurorisë nuk e arrin shumicën e kërkuar, brenda 7 ditëve nga votimi i parë bëhet një votim i dytë, në të cilin Kryetari zgjidhet me shumicën e të gjithë anëtarëve. Mandati i Kryetarit përkon me atë të anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

4. Ministri i Drejtësisë mer pjesë në mbledhjet e Këshillit të Lartë të Prokurorisë për të komunikuar qëndrimet e Këshillit të Drejtësisë për çështje të kompetencës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë.”

21.23. Në nenin 45 hiqet paragrafi 2.

21.24. Nenet 46, 47 dhe 48 propozohet rregullimi me ligj.

21.25. Neni 49 hiqet dhe ngelet siç është sot në Kushtetutë.

21.26. Neni 50 sugjerojmë të transferohet në ligj.

21.27. Neni 52 të hiqet dhe të mbetet siç është parashikuar sot në Kushtetutë.

21.28. Neni 53 të hiqet, pasi nën dritën e propozimeve të bëra nga ana jonë si dhe duke repsektuar rekomandimin për thjeshtim të institucioneve kushtetuese, Këshilli i Emërimeve nuk sjell asgjë të re.

21.29. Neni 54 të hiqet.

21.30. Neni 55 të rishihet sipas propozimeve të bëra nga ne përgjatë tekstit.

21.31. Për nenin 56, propozojmë të rishihet sipas sugjerimit të Komisionit të Venecias, për përfundimin para kohe të mandatit. Ndërprerja e mandatit bëhet

vetëm për ato raste kur institucioni kushtetues nuk parashikohet të ekzistojnë më.

21.32. Per nenet 57 e në vijim propozojmë këtë riformulim:

Dispozitë kalimtare

“1. Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë anëtarët e Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, inspektorët e Inspektoratit të Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë, si dhe këshilltarët ligjorë do t’i nënshtrohen vlerësimit dhe rivlerësimit sipas procedurës dhe kriterëve të parashikuara me ligj.

2. Për kryerjen e procesit të vlerësimit për subjektet e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni, krijohet Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Përbërja, organizimi dhe funksionimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit rregullohet me ligj¹.

3. Komisioni i pavarur i vlerësimit vendos për:

- a. Integritetin moral dhe profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve;*
- b. Pasurinë e tyre në raport me deklaratimet e bëra.*

4. Ndalohet rishikimi i vendimeve të gjykatave të dhëna nga gjyqtarët, përveçse sipas mënyrës dhe procedurës të parashikuara në Kushtetutë dhe në Kodet e Procedurave.

5. Kundër vendimit të Komisionit të Rivlerësimit mund të bëhet ankim në Tribunalin e Drejtësisë.

6. Ligji për Organizimin dhe Funksionimin e Procesit të Rivlerësimit, miratohet me jo më pak se 3/5 e anëtarëve të Kuvendit dhe është i paankimueshëm në Gjykatën Kushtetuese.”

22. Të bindur që argumentet, teksti dhe fryma e ndryshimeve kënaqin dhe përmbushin gjithë ato që ka konstatuar opinioni i Komisionit të Venecias:

-Konsensusin;

-Ndërhyrjet minimaliste në tekstin e Kushtetutës;

-Thjeshtimin e institucioneve;

vlerësojmë dhe besojmë se ky opinion yni mundëson jo vetëm miratimin nga ana formale të këtyre ndryshimeve kushtetuese, por garanton edhe jetësimin dhe jetëgjatësinë e kësaj reforme.